



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kacanik  
Municipal Kacanik  
-Shërbimi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-37041/19  
Kaçanik, 29.11.2019

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e XI-të (Njëmbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik (Legjislatura e VI-të), mbajtur me, 29 Nëntor 2019. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.  
Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës, prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 26 anëtarë. Në mbledhje mungoj pa arsyé anëtarë, Shpend Krusha.

Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, 6-të drejtoret e drejtive komunale (Festim Neziraj, Fatmir Loku, Ramadush Osmani, Ukshin Qallaku, Bahri Selimi dhe Zahir Doda), ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishin: Xhelal Dema, Fadil Guri, Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi dhe Ilirjana Berisha.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Gazmend Murseli.

Nga strukturat vendore, mbledhja u monitorua përmes. Teleprezencës nga Gözim Sahiti, Zyrtar i lartë për monitorimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në MAPL.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu, Zyrtare e Kuvendit.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Mërseli,** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari i përrëndeti të gjithëve, iu uroj mirëseardhje, ndërkaq në shenjë të nderimit të viktimate të shkaktuara nga tërmeti të datës 26 Nëntor në Shqipëri, kërkoj të ngritëm në këmbë për një minutë heshtje.

Në vazhdim konstatoj kuorumin duke i thirrur emër për emër të gjithë anëtarët e KK. Pjesëmarrës në mbledhje janë, 26 anëtarë, ne mbledhje mungon pa arsyé anëtarë Shpend Krusha. Kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e XI-të (Njëmbëdhjetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës, për vitin 2019, data 29 Nëntor, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Harmonizimi i Rregullores për Transparency Komunale 03/2019 (01Nr.02-60/01-31847/19) të datës 17 Tetor 2019 me dispozitat ligjore në fuqi, sipas Kërkesës së MAPL të datës 04.11.2019 ;

3. Propozim Rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020;
4. Propozim Rregullore për ndryshim plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-104/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut;
5. Draft Plani Komunal për integrimin e qëndrueshëm të peronave të riatdhesuar 2019-2022;
6. Propozim Vendimi për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut nga Komisioni për Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale;
7. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
8. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Parcelës kadastrale Nr. 00144-36 Zona Kadastrale Kaçanik, me kulturë pyjore Mal i klasës I, në emër të Seladin Tusha nga Kaçaniku;
9. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës komunale me pronën private, patundshmërinë në PK Nr. 01151-5 në ZK Soponicë, me kulturë, rrugë private në emër të Enver Dalloshi, me pjesën e PK Nr. 01152-0 në ZK Soponicë në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Kaçanik, për ndërtimin e rrugës së f. Soponicë;
10. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës komunale me pronën private, patundshmërinë në PK numrat: 01211-3 dhe 01211-6 me kulturë Arë e klasës së 2, në ZK në Soponicë në emër të Muharrem Dalloshi, dhe pjesa e PK Nr. 01205-0 ZK Soponicë, P.Sh. Kuvendi i Komunës Kaçanik, për ndërtimin e një pjese të rrugës në f. Soponicë;
11. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës komunale me pronën private, patundshmërisë në PK Nr. 00881-2 me kulturë kullosë e klasës së 5 në ZK në Kaçanik në emër të Milaim Fuga nga Kaçaniku dhe pjesën e parcelës Nr. 01855-1, ZK Kaçanik, në emër të rrugë publike e pa kategorizuar, për zgjerimin e rrugës "Nexhmush Fera" në Kaçanik;
12. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të PK Nr. 01356-2 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Kullosë e klasës së 3, në emër të Milaim Elezi;
13. Propozim Vendimi për harmonizimin e mjeteve buxhetore brenda kategorisë së Pagave dhe Mëditjeve për vitin fiskal 2019; dhe
14. Propozimi për lejimin e mjeteve buxhetore në emër të ndihmës për zonat e tërmetit në Republikën e Shqipërisë.

**Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit**, Rendin e propozuar të punës e shtroj në votim për aprovim me 13 pikë dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në ndërkohë u propozua edhe pika e 14 me hyrë në rend pune dhe e njëjta u aprovua njëzëri, kështu që pika e 14 i bashkëngjitet

rendit të punës për shqyrtim. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës në këtë mbledhje.

#### APROVOJ

Rendin e Punës në përbërje prej 14 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

**1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës:**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Materialin e keni marrë, nëse ka kush ndonjë vërejtje lë të urdhëroj. Për ndonjë vërejtje nuk u paraqit kush, atëherë, Procesverbalin e mbledhjes se kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

#### APROVOJ

**Procesverbalin nga mbledhja e X-të (Dhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2019 të datës 31 Tetor 2019 / Lënda: 01Nr. 60/01-34356/19.**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Para se me kaluar në pikët tjera të rendit të punës, nëse ka kush ndonjë pyetje apo kërkesë, lë të urdhëroj:

#### **Pyetjet dhe Kërkesat**

**z. Ekrem Kyçiku,** Shprehi ngushëllime për viktimat në Shqipëri si pasojë e tërmetit të ndodhur të datës 26 Nëntor ! Uroj të gjithë shqiptarët kudo që janë për festën e Flamurit- 28 Nëntorin, ndërkaq në vazhdim parashtroj këto pyetje:

1. Në emër të subjektit politik të LVV, kërkojmë të ndahanen mjetet buxhetore të Komunës Kaçanik, në shumë, 5,000.00 nga KK dhe 5,000.00€ nga Ekzekutivi i Komunës në emër të ndihmës Republikës së Shqipërisë për pasojat e shkaktuara nga tërmeti i ndodhur.
2. Kam marrë një email nga një qytetar i komunës se në komunën tonë, përmes të cilit mesazh jam njoftuar së ende funksionojnë kazinot në komunën Kaçanikut.
3. Kur do të përfundojnë punimet lidhur me ndërtimet të cilat janë duke u bërë në qytet, sepse nga informacionet që kam, afati i kontratës ka përsunduar. Më intereson të di, a është marrë kush në përgjegjësi për mos realizimin me kohë të këtij projekti.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Për çështjen e ndarjes së mjeteve buxhetore për dëmet e shkaktuara nga tërmeti në Shqipëri, biseduam pak më herët me Kryetarin e Komunës, Besim Ilazi. A jeni të pajtimit që kjo pikë të hynë në rend pune, meqë është dashur të propozohet kjo pikë kur u hap diskutimi për rendin e punës. Atëherë për mos më mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme, po e shqyrtojmë këtë pikë në këtë mbledhje. Atëherë, Propozimin e LVV e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjtë u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së, Rendit të punës i shtohet edhe pika e 14. Propozimi për lejimin e mjeteve buxhetore në emër të ndihmës për zonat e tërmetit në Republikën e Shqipërisë.

**z. Adnan Reka,** Kërkojmë që drunjë dekorativ të mbjellë para disa javësh në mes të trotuarit, në rrugën pas ‘Pompës së Benzinës’ d.m.th. në hyrje të Kaçanikut, të kërkohet me kohë nga operatori që t’i zhvendos këta drunj në skaj të trotuarit, ndryshtë kjo punë vërtet nuk ka kuptim.

**z. Hafize Sallahi,** Shprehi shqetësimet e mijë për viktimat e ndodhura në Republikën e Shqipërisë si rezultat i tërmetit të ndodhur. Uroj për festën e 28 –Nëntorit –Ditën e Flamurit të gjithë shqiptarëve kudo që janë.

Pyetjet:

1. Në emër të qytetarëve të komunës paraqes shqetësimet e tyre lidhur me tokat e shpronësuara në vitet, 1960 nga Komuna e Kaçanikut për interes të komunës- për zgjerimin e rrugëve, etj. për të cilat prona, tanë po iu bëhet kompensimi me prona komunale. A ka mundësi komuna me i kompensuar të gjitha ato shpronësimë me pronë komunale apo formë tjeter, të cilat prona në atë kohë janë dhënë në formë vullnetare.
2. Të çështja e dhënies në shfrytëzim afatgjatë – deri në 99 vjet të pronave komunale, shqetësimi i qytetarëve është, a ekziston mundësia e shfuqizimeve vendimeve për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale dhe ndërprerja e kontratave, në rast së marrësit në shfrytëzim të pronave komunale nuk i përmbrushin kushtet e përcaktuara të akteve në fuqi që e rregullojnë këtë fushë.

**z. Nexhat Loku,** Kam një Kërkesë që të hiqet, Shenja e ndalimin të parkingut të shkolla fillore amë “Emin Duraku” në Kaçanik- pjesën e rrugës para oborrit të shkollës, sepse po parkohen auto veturat para hyrjes së oborrit të shkollës në atë pjesë.

**z. Besim Vishi,**

1. Unë kam kërkuar vendosjen e shenjave në rrugë para shkollave të komunës. Një përgjigje e kam marrë nga DSHPE, mirëpo unë kërkoj që pengesat të bëhen me asfalt e jo me gomë të fortë.
2. Ndriçimi publik në rrugën 25 Maji, shiriti i tokëzimit nuk është lidhur ende në gypa. Kjo duhet të bëhet sa nuk ka përfunduar projekti. me qëllim të sigurimit në rast rreziku.

**z. Selim Reka,** Vërejtja ime është të ndërtimi i trotuarit të “Ura e Konakut” nuk e di a është pranuar projekti apo jo. Nëse nuk është bërë pranimi teknik i projektit, kërkoj të mos pranohet ky projekt, sepse ai trotuar ende pa u përfunduar ka filluar me u prishur.

**z. Bekim Koxha,** Të objekti i ndërtesa - BK, janë do shkallë që kanë mbetur pa u hequr. Me intereson të di, pse nuk janë hequr ato shkallë, kur dihet se vendimi për heqjen e shkallëve ka vlefjtur për të gjithë pa përjashtim ?

**znj. Lirije Luta,** Kërkoj të përsëritet Konkursi për mësim jo formal, sepse nuk janë informuar të gjithë ata të cilët kanë qenë të interesuar për me aplikuar.

**z. Shemsedin Luzha,**

1. Me intereson të di, qysh ka mundësi që një punonjës është në pushim e tjetri punon, ndërkaj të dy me u paguar?
2. Përse u vonuan punimet në realizimin e projekti, Ndërtimin e urës në f. Kaçanik i Vjetër ?

**Kryesuesi i Kuvendit,** Pyetje e Kërkesa të tjera nuk ka, besoj së përgjigjet do t'i merrni nga ekzekutivi i komunës, ndërkaj konstatoj me vazhduar me pikët tjera të rendit të punës sipas radhës:

**2.** Harmonizimi i Rregullores për Transparency Komunale 03/2019 (01Nr.02-60/01-31847/19) të datës 17 Tetor 2019 me dispozitat ligjore në fuqi, sipas Kërkesës së MAPL të datës 04.11.2019 :

**Kryesuesi i Kuvendit**, Kjo Rregullore ka ardhur për harmonizim në bazë të Kërkesës së MAPL. Harmonizimi i Rregullores është bërë nga drejtori i DAP, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për. Kundër votë nuk pati, Abstenuan 4 anëtarë nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës.

**Aprovoj**

**Rregulloren për Transparencë Komunale 03/2019 (01Nr.02-60/01-31847/19) të datës 17 Totor 2019, harmonizuar me dispozitat ligjore në fuqi, sipas Kërkesës së MAPL të datës 04.11.2019/ Rregullorja përmban të njëtin numër.**

3. Propozim Rregullorja për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Ne LVV kemi kërkesë që objektet për gjatë rrugës, Glloboçicë, Shtrazë dhe Shterpçë të hynë në Zonën e I, për arsy se janë për gjatë rrugëve magjistrale dhe në afërsi të kufirit. Kërkoj nga shërbimet profesionale të komunës të bëhen, Hartat Zonale për të gjitha zonat.

**z. Selim Reka**, Në KPF kemi kërkuar që, pronat komerciale; shitore, zyrë, restoran, hotel, të gjitha kanë vlerë të njëjtë të tatimit. Unë mendoj se duhet dalluar këto kategori, për shkak se disa kanë qarkullim më të madh, si restorantet dhe hotelet në raport me objektet zyrë.

**z. Adnan Reka**, Unë vazhdoj të mos pajtohem me zonat tatimore në Komunën e Kaçanikut gjithnjë duke pasur parasysh shpërndarjen e buxhetit Komunal, investimet që bëhen nëpër këto zona.

Se pari unë dua t'i di këto zonat urbane që janë të përfshira në Zonën I, II dhe III si janë të ndara, jo në këtë mënyrë të përgjithshme sepse janë të pa definuar. Dhe e dyta, unë mendoj se të gjitha bizneset që konsiderohen Zona I dhe që shtrihen përgjatë magjistrales Prishtinë-Shkup dhe rrugës regionale që fillon nga Fusha e pajtimit deri te udhëkryqi për Prizren të mos përfundoj te ky udhëkryq, por të vazhdojnë deri në kufi me Maqedoninë dhe me Komunën e Shterpçës si Zonë e njëjtë tatimore d.m.th si Zona I.

**z. Besim Vishi**, Të pika 2.2 kërkoj sqarim ku thuhet, të gjitha objektet në parcelat të cilat gjinden pranë rrugës magjistrale Prishtinë - Shkup në tërë territorin e komunës dhe të cilat kanë qasje të drejtpërdrejtë, si dhe ato në pjesën e rrugës regionale Fusha e Pajtimit – Tetovë, deri te udhëkryqi për Prizren, ku thuhet, përfshihen në zonën e I-r, kjo të qartësohet ose të shtohen edhe objekte tjera, sepse ka edhe objekte të tjera përgjatë rrugëve magjistrale të përcaktuara.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Në vitin e kaluar kemi pasur kërkesa që bizneset përgjatë rrugës Doganaj më kaluar në zonën 2. Ne e dimë se nuk mundemi bash tamam me i rregulluar këto çështje, por se paku më i ofruar.

**z. Shemsedin Luzha**, Unë kujtoj se komuna i ka kapacitet me ditur saktë gjendjen e fitimit të firmave që veprojnë në Komunën e Kaçanikut.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Draft Rregullore e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me 11 votë Për, Kundër ishin 10 anëtarë,

Abstenuan 4. Në saje të kësaj del konstatimi së, Kuvendi i Komunës me shumicë të thjeshtë e,

#### APROVOJ

Rregullore për Tatimin mbi Pronën e Paluajtshme për vitin 2020 / Lënda: 01Nr. 05-430/03-36755/19.

4. Propozim Rregullore për Ndryshim Plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-104/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Për Sqarime të nevojshme, fjalën e ka drejtori i DAP - Kryetar i Komisionit, Festim Neziraj.

**z. Festim Neziraj**— Kryetar i Komisionit- E njoftoj KK për ndryshimet të cilat do të bëhen sipas Udhëzimit të ri administrativ. z. Neziraj shtoj së, Administratorët e fshatrave kanë punuar deri me tanë pa pagesë, ndërkaq tanë me ndryshimet e UA do të punojnë me pagesë me shumë të njëjtë me pagesën e komiteteve obliguese të KK, por jo me tepër se për 6 mbledhje për një vit. Ndryshim tjetër është, së, do të zvogëlohet numri i Këshillave të fshatrave nga 33 sa kanë qenë me herët, do të bëhen në 20 Këshilla të fshatrave.

**Kryesuesi i Kuvendit**, I dëgjuat sqarimet e Kryetarit të Komisionit, Festim Neziraj, nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Selim Reka**, Është mirë që po paguhen administratorët e fshatrave tanë e tutje edhe pse ka sfida, ndërkaq propozoj të zgjedhja e këshillave të fshatrave, të futet edhe një pasues si vijon: "Fshrat, lagjet urbane dhe vendbanimet që nuk kanë pasur administrator në vitin e par, në vitin tjetër do të kenë administrator" ose administratorët të zgjidhen me rotacion për 2 vite, sepse sipas Udhëzimit Administrativ të ri, po dihet se Këshillat e fshatrave do të zgjidhen përsëri.

**z. Adnan Reka**, Unë në parim do të isha PËR këtë draft rregullore, por paraprakisht kam një kërkesë nga Drejtori i Administratës, si Kryesues i Komisionit për Themelimin e Këshillave të Fshatrave dhe Lagjeve Urbane,

Ju e dini se procesi zgjedhor për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane ka pasur shumë parregullsi në sh përputhje të plotë me rregulloren, për çfarë unë nuk jam pajtuar. Gjatë asaj periudhe zgjedhore ju thoni, 't'i përfundojmë zgjedhjet njëherë e në fund do të ulemi të diskutojmë për të gjithë procesin zgjedhor', dhe unë po prisja që ju të na ftoni në një takim përmbyllës të procesit zgjedhor dhe të bëjmë një raport për t'i njoftuar Kuvendin dhe opinionin për ecurinë e procesit ashtu siç e kërkon rendi dhe ligji, por ju një gjë të tillë ende nuk e keni bërë që nga korriku i këtij viti kur kishte përfunduar procesi zgjedhor, dhe në asnjë mënyrë nuk e keni konfirmuar atë proces zgjedhor as si të rregullt, as si të parregullt para Kuvendit, prandaj unë konsideroj se nuk ka legitimitet. Meqë ju atë nuk e keni bërë deri tanë, unë ju stoj që këtë proces zgjedhor t'i anuloni apo përsërisni dhe t'i bëni në mënyrë të drejtë në përputhje me rregulloren, dhe paraprakisht të bëhet e ditur se administratorët e fshatrave dhe lagjeve urbane do të paguhen me shumën e përcaktuar me këtë rregullore, dhe pastaj në ato fshatra apo lagje ku nuk ka interesim të konsiderueshmët të mos zgjedhet këshilli me çdo kusht në atë periudhë kohore, por të shtyhet për në një periudhë kohore kur banorët e atij lokaliteti të shprehin interesim më të madh.

**Kryesuesi i Kuvendit**, ME Udhëzimin Administrativ (UA) të ri, ky proces anulohet jo për parregullsi, por për shkak se ka ndryshuar UA. Propozimi i z. Selim Reka ishte i mirë që

administratori i fshatrave të zgjidhet me rotacion. Këtu nuk është shënuar, por ne do të merremi përsëri me këtë çështje, pasi që Rregullorja ka me u shqyrtuar edhe në lexim të dytë nga Kuvendi i Komunës.

**z. Adnan Reka,** Unë për disa çështje u pajtova e për disa jo. Një prej parregullsive është se që 6 muaj që janë zgjedhur Këshillat e fshatrave, ende nuk ka ndonjë raport sesi janë zgjedhur.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Procesi ka ngecur si ka ardhur Udhëzimi i ri administrativ. Pjesë përbërëse e kësaj rregullore është emërimi i Këshillave të fshatrave.

**z. Adnan Reka,** Parregullsi ka pasur në zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, ndërkaq nëse ka ndryshuar Udhëzimi Administrativ për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, atëherë është dashur me na njoftuar.

**z. Festim Neziraj,** Ne si komision për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave, nuk kemi munduar me sjellë raport pa përfunduar i gjithë procesi i zgjedhjes së këshillave të fshatrave. Kur të përfundon i gjithë procesi do të dalim me raport për krejt aktivitetin e zhvilluar.

**z. Bekim Koxhaj,** Fshatrat; Görlica e Epërme, Bajnicë, Semajë janë bërë dy këshilla të fshatrave, ndërkaq Görlica e Epërme më herët ka qenë me fshatrat, Duraj e Elezaj. Ku është arsyja dhe a mund të funksionojnë në këtë formë këshillat e këtyre fshatrave.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Edhe unë kam pasur vërejtje të tilla për shkak se këshillat e fshatrave mund të funksionojnë me lehtë që janë gjeografikisht me afër më zona kadastrale. Kjo çështje kujtoj se do të rregullohet pas debatit publik me qytetarë të komunës, pasi që Rregullorja është në lexim të parë dhe e njëjta do të vjen edhe një herë në KK në lexim të dytë.

Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë Rregullore e shtroj në votim për me lëshuar në procedurën e Diskutimit Publik; Rezultati i votimit, Për, votuan shumica, Kundër ishin 4 anëtarët nga LVV, Abstenoj, Ekrem Raka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori.

#### VENDIM

Për Lëshim në Diskutim Publik të Propozim Rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores 01/2018 (01Nr. 02-104/01-11899) për bashkëpunimin e komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Kaçanikut / Lënda: 01Nr. 02-60/01-36408.

**5. Draft Plani Komunal për integrimin e qëndrueshëm të peronave të riatdhesuar 2019-2022:**

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçku,** Ky draft Plan është i hartuar mirë, ndërkaq sesa realizohet është çështje tjetër.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Meqë nuk ka kush diçka, atëherë këtë Plan Komunal për rri integrim e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

## VENDIM

Për Aprovimin e Planit Komunal për integrimin e qëndrueshëm të peronave të riatdhesuar 2019-2022 / Lënda: 01Nr. 60/01-36491/19.

6. Propozim Vendimi për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkesave dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut nga Komisioni për Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Në KPF ka pasur Kërkesa nga Komuniteti i f. Biçec lidhur me emërtimet e rrugëve dhe një kërkesë tjetër ka qenë nga Valdet Raka, për një riemërtim të një rruge në Kaçanik. Ky i njëjtë nuk e kishte ditur që është duke punuar komisioni për emërtimin e rrugëve, kështu që ka bërë një Kërkesë për riemërimin e një rruge në Kaçanik. Në KPF janë prolonguar rrugët në Biçec dhe çështja e rrugës për riemërtim të propozuar nga Valdet Raka. Meqë për rrugët në f. Biçec kemi kërkesa dhe ankesa, atëherë t'i vazhdohet mandati komisionit deri në përfundimin e krejt procesit. Paraprakisht iu njoftoj se emërtimi i rrugëve bëhet me 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve apo me 18 votë Për. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**znj. Hafize Sallahu**, Unë kam një shkresë nga Këshilli i f. Biçec, të cilën shkresë e lexoj znj. Sallahu, ndërkaq shtoj së Këshilli i fshatit Biçec është legjitim dhe çdo kush nga f. Biçec që ka diçka, duhet t'i drejtobet këshillit të zgjedhur të fshatit, kur dihet së Komisioni për zgjedhjen e Këshillave të fshatrave është zgjedhur nga Kuvendi i Komunës dhe ai komision është legjitim i cili i ka zgjedhur këshillat e fshatrave. Problemet për emërtimin e rrugëve të f. Biçec ka ardhur si rezultat i mosbashkëpunimi të komisionit me këshillin e fshatit. Këshilli i këtij fshati propozon të shtyhet çështja e emërtimit të rrugëve lokale në fshatin Biçec, për shkak të mospajtimeve të krijuara rrëth emërtimit të një rruge dhe mos bashkëpunimin e fshatit me Këshillin e fshatit. Këshilli i f. Biçec kërkon që emërtimet e rrugëve në Biçec mos të miratohen në këtë seancë.

**z. Nexhat Loku**, Në KPF ka qenë propozim me u prolongua një rrugë e f. Biçec dhe një Kërkesë për riemërtimin e një rruge në Kaçanik dhe ashtu është vendosur.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Në KPF i kemi prolonguar emërtimin e rrugëve në f. Biçec, ndërkaq f. Biçec në bashkëpunim më Këshillin e fshatit dhe OJQ e dala nga lufta e UÇK të merren me këtë punë.

**z. Bekim Koxha**, Të kriteret e emërtimit të rrugëve po duhet me pasur kujdese, sepse po na kushtojnë në të ardhmen. Më mirë të merret fshati Biçec më emërtimet e rrugëve të tyre, pastaj të na e sjellin neve propozimet për miratim pasi t'i harmonizojnë qëndrimet e tyre.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Meqë çështja e emërtimit të rrugëve lokale kërkon miratimit e 2/3 të votave të anëtarëve të KK nga numri i përgjithshëm apo 18 votë. Kërkoj mendimin e grupeve parlamentare të përfaqësuara në KK.

**z. Ekrem Raka**, Unë si qytetar i komunës së Kaçanikut jam i pakënaqur me procesin e emërimit të rrugëve, kështu që do të abstenoj në këtë pikë.

**z. Ekrem Kyçiku**, Anëtarin nga LVV që ka qenë anëtar i komisionit për emërtimin e rrugëve, z. Shpend Krusha nuk e kemi këtu prezent në këtë mbledhje. ndërkaq nuk kemi shumë njohuri me emrat që do të emetohen rrugët, kështu në këtë proces ne LVV do të abstenojmë.

**z. Selim Reka,** Anëtarin tonë nga LDK e kemi pasur të përfaqësuar në këtë proces, ndërkaq me rishqyrtuar edhe një herë këtë çështje, kujtoj se është pak e ndjeshme, kështu LDK do e mbështesim këtë Propozim Vendim për emërtimin e rrugëve.

**znj. Afërdita Shehi,** Theksoj, f. Biçec e ka një Këshill dhe ai Këshill duhet të bashkëpunoj me fshatin për me i harmonizuar qëndrimet.

**z. Shemsedin Luzha,** Konfirmoj vendimin e tij së kur kjo çështje do të shtrohet në votim, unë do të abstenoj.

**z. Festim Neziraj,** Rrugët në f. Biçec u prolonguan, ndërkaq rishikoni edhe një herë propozimet për emërtimet e rrugëve lokale, në mënyrë që mos të mbeten peng propozimet e dhëna.

**z. Sali Malsiu,** Ne si komision për emërtimin e rrugëve lokale, nëse vazhdojmë tutje, anëtarë Shpendi nuk është këtu, kështu që duhet të bëhet zëvendësimi i tij për me funksionuar komisioni në përbërje të plotë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Ne nuk kemi asnjë konfirmim nga Shpendi dhe subjekti politik i LVV. Ne nuk mund të marrim veprime as me zëvendësuar Shpendin, sepse nëse kthehet, mund të na krijohen probleme. Komisioni për emërtimin e rrugëve, pos Shpendit ka edhe 4 anëtarë tjerë dhe mund të vazhdoj të funksionoj me përbërjen aktuale që ka. Nëse nuk ka kush diçka, atëherë me heqjen e nenit 5 dhe kërkesa Valdet Raka për riemërtimit të një rruge, nuk hynë në këtë vendim, e shtroj në votim për aprovim për aprovim; Rezultati i votimit është, Për votuan 20 anëtarë, Kundër votë nuk pati, Abstenuan 6 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi se me shumicë absolute 20 votë Për, Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale pas shqyrtimit të ankesave, kërkeseve dhe propozimeve nga qytetarët e Komunës së Kaçanikut nga Komisioni për Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale/ Lënda: 01Nr. 104/02-36179/19.

Komisionit i vazhdohet mandati deri në përfundimin tërë procesit të emërtimit të gjitha rrugëve lokale, pasi që ka ende rrugë të paemërtuara.

7. Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës:

**Kryesuesi i Kuvendit,** Me ligjin e ri, çdo pronë që jepet në shfrytëzim duhet të formohet komision i veçantë. A i lëmë ata anëtarë që janë apo propozojmë emra të tjerë, me rëndësi është që komisioni duhet të ripërtërihet. Nëse nuk ka kush diçka, shkojmë me propozime konkrete.

**z. Ekrem Kyçiku,** Nga LVV e propozoj për anëtar të komisionit, Adnan Reka.  
**z. Nexhat Loku,** Nga PDK e propozoj për anëtar të komisionit, Kadri Krivenjeva.

**z. Ekrem Raka,** Pyeti, a mundet me votua KK këtë vendim, pa u dhënë edhe emrat për 2 anëtarët nga ekzekutivi dhe 1 anëtar nga OJQ.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Kuvendi i Komunës vendosë për dy emrat nga KK, ndërkaq vendimi plotësohet me 2 anëtarë që i propozon Kryetari i Komunës dhe 1 anëtarë vjen nga OJQ.

Propozimet që dolën i shtroj në votim për aprovim dhe të njëjtat u aprovuan me vetëm një votë kundër, atë të Bekim Koxha.

Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës si vijon:

1. Kadri Krivenjeva nga KK
2. Adnan Reka nga KK
- 3.....nga Ekzekutivi i Komunës,
4. ....nga Ekzekutivi i Komunës, dhe
5. ....nga OJQ / Lënda: 01Nr. 60/01-36810/19.

Nga Ekzekutivi i Komunës për anëtarë të komisionit janë caktuar: Besnik Bajra dhe Remzi Shabani. Ndërkaq OJQ e ka sjellë propozimin me shkrim për, Zekirja Elezi.

8. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Parcelës kadastrale Nr. 00144-36 Zona Kadastrale Kaçanik, me kulturë pyjore Mal i klasës 1, në emër të Selajdin Tusha nga Kaçaniku;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku**, Unë edhe në mbledhje të KPF nuk jam pajtuar të merret paraprakisht vendimi, për shkak së fillimi që duhet të merret Pëlgimi nga Ministria e linjës. Deri me tanë nuk kemi pasur ndonjë pëlgim paraprak nga ministria, për me vendosur në bazë të pëlgimit.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër 4 anëtarë të LVV, Abstenuan 4 anëtarë. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori ,

#### **VENDIM PARAPRAK**

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore të Parcelës kadastrale Nr. 00144-36 Zona Kadastrale Kaçanik, me kulturë pyjore Mal i klasës 1, në emër të Selajdin Tusha nga Kaçaniku / Lënda: 01Nr. 06-350/01-33963/19.

9. Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës komunale me pronën private, patundshmërinë në PK Nr. 01151-5 në ZK Soponicë, me kulturë, rrugë private në emër të Enver Dalloshi, me pjesën e PK Nr. 01152-0 në ZK Soponicë në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Kaçanik, për ndërtimin e rrugës së f. Soponicë;

**Kryesuesi i Kuvendit**, Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**znj. Vlora Dalloshi**, Në këtë çështje për shkak të konfliktit të interesit, unë, tërhiqem nga diskutimi dhe votimi.

**z. Bekim Koxha**, Kërkoj sqarime të nevojshme për pronën në fjalë se a janë në dijeni komuniteti, nëse po, a janë pajtuar me u këmbyer këto prona.

**z. Ukshin Qallaku**, Deri sa prona në fjalë është rrugë e pa kategorizuar, na lejohet këmbimi i pronave në fjalë. Këto prona janë në megjë dhe për mos me ardhur deri të procedurat gjyqësore, kemi kërkuar me bërë këmbimin e tyre.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Sqaroj se ku gjenden pronat në fjalë dhe arsyet e këmbimit të tyre.

**z. Shemsedin Luzha,** Unë konfirmoj vendimin tim së kur kjo çështje do të dal në votim, vota ime shkon kundër.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Diskutime të tjera nuk ka, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishte Shemsedin Luzha, Abstenuan 5 anëtarë, një anëtar nuk votoj për shkak të konfliktit ë interesit. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës komunale me pronën private, patundshmérinë në PK Nr. 01151-5 në ZK Soponicë, me kulturë, rrugë private në emër të Enver Dalloshi, me pjesën e PK Nr. 01152-0 në ZK Soponicë në emër të P.Sh. Kuvendi i Komunës Kaçanik, për ndërtimin e rrugës së f. Soponicë / Lënda: 01Nr. 46401-36826/19.

**10.** Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës komunale me pronën private, patundshmérinë në PK numrat: 01211-3 dhe 01211-6 me kulturë Arë e klasës së 2, në ZK në Soponicë në emër të Muharrem Dalloshi, dhe pjesa e PK Nr. 01205-0 ZK Soponicë, P.Sh. Kuvendi i Komunës Kaçanik, për ndërtimin e një pjese të rrugës në f. Soponicë;

**Kryesuesi i Kuvendit** Sqaroj se edhe të kjo pikë kemi të bëjmë me shpalljen e interesit të përgjithshëm dhe këmbimin e pronës për interesin e përgjithshëm të komunës për ndërtimin e rrugës në f. Soponicë. Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishte Shemsedin Luzha, Abstenuan 4 anëtarët nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës komunale me pronën private, patundshmérinë në PK numrat: 01211-3 dhe 01211-6 me kulturë Arë e klasës së 2, në ZK në Soponicë në emër të Muharrem Dalloshi, dhe pjesa e PK Nr. 01205-0 ZK Soponicë, P.Sh. Kuvendi i Komunës Kaçanik, për ndërtimin e një pjese të rrugës në f. Soponicë / Lënda: 01Nr. 464/01-36827/19.

**11.** Propozim Vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës komunale me pronën private, patundshmérinë në PK Nr. 00881-2 me kulturë kullosë e klasës së 5 në ZK në Kaçanik në emër të Milaim Fuga nga Kaçaniku dhe pjesën e parcelës Nr. 01855-1, ZK Kaçanik, në emër të rrugë publike e pa kategorizuar, për zgjerimin e rrugës "Nexhmush Fera" në Kaçanik;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin; Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër votë nuk parti, Abstenuan 5 anëtarë (4 anëtarët nga LVV dhe Shemsedin Luzha). Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### **VENDIM**

Për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për këmbimin e pronës komunale me pronën private, patundshmérinë në PK Nr. 00881-2 me kulturë kullosë e klasës së 5 në ZK në Kaçanik në emër të Milaim Fuga nga Kaçaniku dhe pjesën e parcelës Nr. 01855-1, ZK Kaçanik, në emër të rrugë publike e pa kategorizuar, për zgjerimin e rrugës "Nexhmush Fera" në Kaçanik / Lënda: 01Nr. 464/01-36830/19.

12. Propozim Vendimi Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të PK Nr. 01356-2 /ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Kullosë e klasës së 3, në emër të Milaim Elezi:

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 4 anëtarët nga LVV, Abstenuan Ekrem Raka dhe Shemsedin Luzha. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM PARAPRAK

Për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të PK Nr. 01356-2 ZK Kaçanik i Vjetër, me kulturë bujqësore Kullosë e klasës së 3, në emër të Milaim Elezi / Lënda: 01Nr. 351/02-33644/19.

13. Propozim Vendimi për harmonizimin e mjeteve buxhetore brenda kategorisë së Pagave dhe Mëditjeve për vitin fiskal 2019;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë këtë çështje e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjtë u aprovua me shumicën e votave Për, Kundër ishin 4 anëtarët nga LVV, Abstenuan; Ekrem Raka dhe Shemsedin Luzha. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për harmonizimin e mjeteve buxhetore brenda kategorisë së Pagave dhe Mëditjeve për vitin fiskal 2019 / Lënda: 01Nr. 400/01-37089/19.

14. Propozimi për lejimin e mjeteve buxhetore në shenjë ndihme Republikës së Shqipërisë për tërmetin e ndodhur;

**Kryesuesi i Kuvendit,** Fillimi sht fjalën ia jap Kryetarit të Komunës, Besim Ilazi me na sqaruar se a ka mundësi buxhetore me ndarë për këtë destinim;

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi,** Edhe unë në emër të Komunës shprehi keqardhje për tërmetin e ndodhur në Shqipëri, shprehim ngushëllime për viktimat e tërmetit, ndërkaq me pëlqeu propozimi i Ekrem Kyçyku, për me përkrahur me mjete financiare zonat e tërmetit, ndërkaq në bisedë me drejtorin që patëm, janë, 7,000.00€ që mund t'i ndajmë nga subvencionet dhe transferet duke shikuar të gjitha mundësitë.

**Kryesuesi i Kuvendit,** Nëse ka kush diçka e hapi diskutimin:

**z. Ekrem Kyçyku,** Unë propozova të ndahen 5.000.00€ nga buxheti i KK dhe 5.000.00€ nga Buxheti i Zyrës së Kryetarit të Komunës.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi,** Ka pasur edhe një iniciativë nga kompania "Elita Tours" me ndihmuar me veshmbathje dhe gjera ushqimore të prekurit nga tërmeti në Shqipëri dhe iniciativës së tillë iu kanë përgjigjur pozitivisht shumë qytetarë të komunës, ashtu që dërgimi është bërë edhe nga kompanitë: "Elita Tours" dhe Beka" dhe disa automjete tjera me të vogla të personave privat, ndërkaq sesa ka mundësi me u ndarë mjete, na sqaron drejtori i financave, Bahri Selimi.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Me kontingjentin e ndihmave që u dërguan nga komuna e jonë kam qenë mbrëmë edhe unë dhe gjendja është e rëndë atje.

**z. Bahri Selimi**, Atë që tha Kryesuesi i Kuvendit, ne e biseduam më herët me Kryetarin dhe Kryesuesin, Iniciativa është me vend, koha që jemi në përfundim të vitiit është e vështirë me ndarë mjete, pos nga subvencionet dhe transferet dhe atë nga Nën programi buxhetor-Zhvillimi ekonomik dhe nën programi buxhetor- Mirëqenie sociale.

**z. Selim Reka**, Pajtohem me iniciativën për ndarjen e mjeteve buxhetore në emër të ndihmës për tërmetin në Shqipëri, ndërkaq unë propozoj që një shumë simbolike t'i ndahet familjeve nga Gjilani që humbën dy anëtarë në atë tragjedinë e tërmetit të ndodhur në Shqipëri.

**Kryetari i Komunës**, Nëse shtohen edhe shuma, 3,000.00€ që po kërkohet, mundemi ato mjete me i marrë nga subvencionet e Bujqësisë dhe të njëjtat me ua proceduar në vitin vijues me buxhet të vitiit 2020.

**z. Ekrem Kyçiku**, Unë kujtoj se shuma nën 10,000.00€ nuk na bënë nderë si komunë, kështu që unë qëndroj pran propozimit të cilin e potencova në fillim.

**Kryesuesi i Kuvendit**, A jeni që shuma 10,000.00€ të ndahan në emër të ndihmës familjarëve të prekur nga tërmeti, ndërkaq për familjet në Gjilan mundemi edhe me vonë me vendosur me ndonjë vendim tjetër.

**z. Bekim Koxha**, Edhe në NISMA e mbështetim iniciativën me ndarë shumën 10,000.00€ në emër të ndihmave familjeve të prekura nga tërmeti në Shqipëri.

**Kryesuesi i Kuvendit**, Meqë nuk ka kush diçka tjetër, atëherë Propozimin për ndarjen e shumë 10,000.00€ e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

Për ndarjen e shumës 10,000.00€ (Dhjetëmijë euro) në emër të ndihmës nga tërmeti, Republikës së Shqipërisë. Mjetet buxhetore do të ndahan nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve nga tre nën programe buxhetore/ Lënda: 01Nr. 400/01-38417/19.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e të përfunduar në ora 12:46. Deri në fund të mbledhjes qëndruan 26 anëtarët sa ishin prezent në mbledhje edhe në fillim.

Procesmbajtës  
Makfire Malsiu



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 22 Tetor 207);**

**nga Mbledhja e XI (Njëmbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës  
për vitin 2019, mbajtur me 29 Nëntor 2019.**

1. Kemal Mërseli.....,.....,
2. Hamid Guri.....,.....,
3. Ahmet Luma ..... ,.....,
4. Kadri Krivenjeva,.....,.....,
5. Besim Vishi,.....,.....,
6. Sali Malsiu.....,.....,
7. Lirije Shurdhani.....,.....,
8. Pranverë Loku- Zharku.....,.....,
9. Lirije Luta.....,.....,
10. Vlora Dalloshi.....,.....,
11. Nexhat Loku .....,.....,
12. Shpend Krusha.....,.....,
13. Adnan Reka.....,.....,
14. Ekrem Kyçyku.....,.....,
15. Fatijona Kyçyku.....,.....,
16. Kaltrina Tafili .....,.....,
17. Selim Reka.....,.....,
18. Besnik Salihu,.....,.....,
19. Nazife Krasniqi.....,.....,
20. Arlinda Rakoci-Raka.....,.....,
21. Shemsedin Luzha.....,.....,
22. Albana Troni.....,.....,
23. Afërdita Shehi,.....,.....,
24. Hajredin Luta.....,.....,
25. Hafize Sallahi .....,.....,
26. Bekim Koxha.....,.....,
27. Ekrem Raka,.....,.....,



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

### DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS

#### Përgjigje në pyetjen e z. Shemsedin Luzha,

Me intereson të di, qysh ka mundësi që një punonjës është në pushim e tjetri punon, ndërkaq të dy me u paguar ?

**Përgjigje:** Mësimdhënësi Sefedin Luzha për shkaqe shëndetësore në dy vitet e fundit nuk është në gjendje të udhëheq klasë prandaj në shumicën e kohës ka qëndruar në pushim pa pagesë apo pushim mjekSOR. Për gjendjen e tij shëndetësore ka ofruar fakte dhe ka kërkuar pensionim të parakohshëm, por kjo nuk ka qenë e mundur ligjërisht. Në këtë rast duhet që mësimdhënësi të zëvendësohet gjë që me konkurs publik është bërë zëvendësimi ndërsa Sefedin Luzha është caktuar mësues asistent. Sa për dijenin tuaj, mësimdhënësi në fjalë pensionohet edhe katër muaj ndërsa vendi i tij i punës është shpallur i lirë me konkurs publik.

